



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.821/I prot.

Peshkopi, më 07.10.2024

Lënda: Për vendimin nr.46, datë 30.09.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.46, datë 30.09.2024 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër 8 mujori vitit 2024”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës dhe probleme të ngjashme, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU



PREFEKATURA DIBËR

Ardhur

Nr. 821 dt. 07.10.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3576

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 07/10.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.46

Datë: 30.09.2024

“Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër 8-mujori viti 2024”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



Kopje
07.10.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 46 Datë 30 / 09 /2024

“Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër 8-mujori vitit 2024”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 9 pika 1.3, shkronja “c”, neni 18, neni 34, neni 40, neni 41, neni 54, shkronja “dh”, neni 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 44, pika 4, të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër me nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.24/1 datë 11.01.2024, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **30.09.2024**, me 21 vota pro, 0 kundër dhe 3 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër për 8-mujorin e vitit 2024.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja Ekonomike (Sektori i Financës) Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **30.09.2024**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irini SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - VENDIM
Nr. 13 datë 23/08/2024

“Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Diber 8-mujori viti 2024”

Këshilli Bashkiak Diber në mbledhjen e tij të datës ___/___/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Diber, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 18, 34, 40, 41, 54, shkronja “dh”, 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, keu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 44, pika 4, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Diber nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Diber me vendimin, nr.24/1 prot datë 11.01.2024 i ndryshuar

Kërkojmë:

- I. Miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Diber për 8-mujorin e vitit 2024.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Diber.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtor Juridik
Ismet SARAÇI

Sp/Buxheti
Erblina SEDA

Drejtor Ekonomik
Çeljeta Zuna

KRYETARI

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT PER
8- MUJORIN E VITIT 2024

Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, nenit 65 të ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, të ligjit 139/215 “ Per veteqeverisjen vendore”, si dhe Udhezimit nr.22 date 30.07.2018 “ Per proceduarat standarte te monitorimit te Buxhetit te Njesive vendore”po ju paraqesim raportin e monitorimit te zbatimit te treguesve te buxhetit per 8 mujorin e vitit 2024. Bashkia Diber miratoi buxhetin e vitit 2024 me VKB nr.139 date 29.12.2023, konfirmim e institucionit te Perfektit te Qarkut Diber nr.24/1 prot. Date 11.01.2024 dhe , i cili me pas u dergua per celje prane deges se thesarit brenda afatit ligjor .

Raporti i Monitorimit te Buxhetit permban si me poshte :

A.Burimet e Financimit

B.Te ardhurat e veta te Bashkise Diber.

C.SHPENZIMET (analiza e shpenzimeve sipas programeve)

- Politika e programit
- Pershkrimi i programit
- Qellimi i politikës së programit
- Objektivat e politikës së programit
- % e realizimit të shpenzimeve në fakt krahasuar me planin

D.Treguesit e performances

E.Realizimi i shpenzimeve 8- mujorit të vitit 2024 F.Treguesit financiare

G.Detyrimet e prapambetura

A.Burimet e Financimit

Per 8-mujorin e viti 2024 u planifikuan te ardhura vjetore ne leke te ndara si me poshte :

Te ardhura nga taksat e tarifat vendore	231,970.000 leke
Te ardhura nga transferta e pakushtezuar	523,183,975 leke
Te ardhura nga transferta sektoriale	206,454,213 leke
Transferte e kushtezuar e etj.	327,311,000 leke

Nr	EMERTIMI	Plani I 8-mujorit te pare te vitit 2024	% qe ze cdo ze ndaj totalit
1	Trasferta e pakushtezuar	523,183,975	-
	Shuma Trasferta e pakushtezuar	523,183,975	54.4%
1	Trasferta e kushtezuar etj	327,311,000	
	Shuma Trasferta e kushtezuar	327,311,000	31.9%
2	Trasferta specifike Arsimit parashkollor	126,974,414	
3	Trasferta specifike Arsimit parauniversitar	7,923,405	
4	Trasferta specifike Ujitja dhe kullimi	12,182,997	
5	Trasferta specifike Mbrojtja kunder zjarrit (PMNZSH)	20,866,356	
6	Konvikti	18,874,041	
7	Administrimi i Pyjeve	7,283,000	
8	Rruge rurale	12,350,000	
	Shuma Trasferta Sektoriale	206,454,213	21.4%
	Shuma e Transfertes	729,638,188	75.8%
1	Te ardhura Taksa Vendore	108,197,000	
2	Te ardhura Tarifa Vendore	85,233,000	
3	Te Ardhura Qera & Shitje Pasurie	26,420,000	
4	Te tjera	12,120,000	
	Shuma e te Ardhurave	231,970,000	2%
	TOTALI I BURIMEVE TE FINANCIMIT te 8-mujorit te vitit 2024	961,608,188	100%

B.TE ARDHURAT PER 8-MUJORIN TE VITIT 2024

Tabela e realizimit te te ardhurave per 8-mujorin e vitit 2024

NR	EMERTIMI I LLOJEVE TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE	PLANI MIRATUAR 8-MUJORI(2024)	REALIZIMI I TE ARDHURAVE 8-MUJORI(2024)	REALIZIMI NE %
	Total te ardhura Vendore	231,970,000	110,510,946	48
I	Te ardhura Taksa Vendore	103,197,000	38,766,372	36
1	Tat. Thjeshtuar mbi Fitimin	2,667,000	603,179	23
2	T.mbi Pasurine e Paluajtshme	21,447,000	8,751,122	41
	a) Takse ndertese	14,180,000	6,738,099	48
	Biznese	11,750,000	6,280,850	53
	Familje	2,167,000	257,769	12
	Debitoret	263,000	199,480	76
	b) Takse toke Bujqesore	6,300,000	1,228,325	19
	c) takse mbi truallin	967,000	784,697	81
	Biznese	750,000	662,335	88
	Familje	217,000	122,362	56
3	Takse Autorizimi(karburante ,lende gazi)	2,200,000	400,000	18
4	Taksa e fjetjes ne Hotel	6,100,000	261,850	4
5	T.ndikt ne infrastrukture	50,667,000	9,314,292	18
6	T.mbi Tras Pasuri.Paluajtsh	450,000	116,918	26
7	T.Vjetore Mjeteve Perdorura	22,667,000	18,532,511	82
8	T.zenien e hapesires publike	666,000	-	-
9	Taksa e tabelës, reklame	1,333,000	786,500	59
II	Te ardhura Tarifa Vendore	85,233,000	35,051,242	41
1	Tarife e Pastrimit	32,017,000	15,577,244	49
	a) Biznese	15,000,000	8,469,490	56
	b) Institucione	1,933,000	1,448,000	75
	c) Familje	13,500,000	4,973,974	37
	d) tregtaret ambulante	167,000	-	-
	Debitoret	1,417,000	685,780	48
2	Tarife e Ndrjimit Rrugor	3,863,000	1,322,290	34
	a) Biznese	1,933,000	1,049,440	54
	b) Institucione	127,000	116,000	91
	c) Familje	1,567,000	58,550	4
	d) tregtaret ambulante	53,000	-	-
	e) Debitoret	183,000	98,300	54
3	Taksa e Pulles	3,500,000	591,000	17
4	Tarife Parkimi te automjeteve	1,133,000	558,000	49
5	Tarife licensimi automjeti.	1,167,000	759,870	65
6	Tarife Veterinarie.	133,000	-	-
7	Tarife ,shitja e shtypshkrimeve.	267,000	127,000	48

8	Tarife Gjellërimi Publik	1,320,000	889,498	67
	a) Biznese	1,133,000	761,484	67
	b) Institucione	73,000	68,800	94
	c) tregtaret ambulante	37,000	-	-
	d) Debitoret	77,000	59,214	77
9	Kuote ushqim Cerdhe, Kopshte.	8,500,000	7,466,690	88
10	Tarife e shërbimit ne Llixha.	33,333,000	7,759,650	23
III	Te Ardhura Qera & Shitje Pasurie	26,420,000	21,677,719	82
1	Qera Truall	24,333,000	20,991,321	86
2	Qera Ndertese & Banese	1,217,000	436,398	36
3	Nga kullotat	667,000	-	-
4	Sherbime MNZ	150,000	250,000	167
5	Renta Minerare	53,000	-	-
IV	Te tjera	12,120,000	15,015,613	124
1	Të tjera tarifa administrative dhe rregullatore të njëjësive vendore	2,467,000	654,900	27
2	Gjoha të policisë së ndërtimit	133,000	170,000	128
3	Të tjera gjoha	53,000	109,000	206
4	Të tjera të ardhura jo tatimore	867,000	247,781	29
5	Të ardhurat nga procedurat e tenderave	267,000	-	-
6	Grant nga pjesëmarrja për TAP	8,333,000	9,657,399	116
7	Gjoha t e policise rrugore	-	21,500	-
8	Gjoha t e policise bashkiake	-	157,000	-
9	Kamatevonesa	-	37,640	-
10	Te tjera nga shitja e mallrave e shërbimeve	-	10,000	-
11	Transferime te tjera NJPV	-	1,800,000	-
12	Te ardhura nga org.nderkombetare	-	2,150,393	-

Realizimi i te ardhurave te veta per 8- mujorin e vitit 2024 ne Bashkine Diber eshte 48%
Plani per 8- mujorin eshte ne masen 231.970.000 leke
Fakti per 8- mujorin eshte ne masen 110.510.946 leke
% e realizimit per 8- mujorin eshte 48%

C. SHPENZIMET

U planifikuan ne total shpenzime vjetore per 8- mujorin e vitit 2024 ne shumen 1,767,499 mije leke dhe u shpenzuan ne fakt ne shumen 1,297,243 mije leke ose 73,4%
Planifikimi i shpenzimeve eshte ne baze te programeve si me poshte:

Realizimi i shpenzimeve per 8- mujorin e vitit 2024 ne Bashkine Diber sipas programeve paraqitet si me poshte:

000 mije

Emri i Grupit		BASHKIA DIBER					Kodi i Grupit	133
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	
Titulli	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes /progresiv	Fakti i Periudhes /progresiv	
01110	PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMIINSTRIMI	273,877	273,768	273,768	282,842	199,290	170,575	
06260	SHERBIMET PUBLIKE VENDORE	165,309	130,214	130,214	135,621	96,880	76,469	
03140	SHERBIMET E POLICISE VENDORE	7,375	8,793	8,793	8,793	6,366	6,364	
03280	MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE	27,108	29,303	29,303	29,303	21,031	18,505	
04220	SHERBIMET BUJQESORE, INSPEKTIMI, USHQIMI DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE	-	-	-	22,975	9,890	9,890	
04240	MENAXHIMI I UJITJES DHE KULLIMIT	16,902	27,043	27,043	31,868	19,461	19,461	
04260	MENAXHIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE	6,843	9,807	9,807	9,336	7,283	5,053	
04520	RRJETI RRUGOR RURAL	114,123	242,009	242,009	313,423	261,182	124,735	
05100	MENAXHIMI I MBETJEVE	59,775	18,504	18,504	20,293	15,838	13,173	
06370	FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIME	251,161	47,501	47,501	47,501	47,501	34,044	
07220	SHERBIMET E KUJDESIT PARESOR	33,151	37,891	37,891	25,550	25,550	19,472	
08130	SPORT DHE ARGETIM	38,135	36,662	36,662	36,662	28,080	26,053	
08220	TRASHEGIMIA KULTURORE, MONUMENTET, MUZETE DHE BIBLIOTEKAT	28,638	21,034	21,034	21,489	14,969	12,902	
09120	ARSIMI BAZE DHE PARASHKOLLORE	214,187	272,672	272,672	292,551	206,191	186,698	
09230	ARSIMI I MESEM E PERGJITHSHEM	47,056	37,305	11,496	11,496	7,923	7,367	
10430	Ndihme paaftesi	1,072,436	807,532	807,532	807,532	800,094	566,482	
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		2,356,076	2,000,038	1,974,229	2,097,235	1,767,499	1,297,243	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit		-	-	-	-	-	-	

Aanaliza e shpenzimeve sipas programeve:

➤ **Programi 01110 Planifikim , menaxhim dhe Administrim**

Politika e Programit. Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të administratës publike përmes rritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies së punonjësve publikë, modernizimit të institucioneve dhe shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, duke përfshirë rritjen e efikasitetit përmes zbatimit të zgjidhjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Përmirësimi i procedurave administrative dhe mbikëqyrëse nëpërmjet rritjes së kontrollit të aktivitetit të administratës publike dhe sigurimit të të drejtave të qytetarëve dhe lehtësimit të procedurave.

Përshkrimi i programit

- Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Diber dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacionin.
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
- Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi etj.
- Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë.
- Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;

Qellimi i politikës së programit: Qeverisja Vendore e Përgjegjese dhe Transparente.

Objektivat e politikës së programit: Aparati i Bashkisë ka si objektiva formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës. Për 8- muajin e vitit 2024 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për 8- muajin e vitit 2024 janë analizuar si më poshtë:

Objektiv 1. Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Administratën e Bashkisë nëpërmjet rekrutimit sipas legjislacionit në fuqi sipas parimit të meritës, aftësive dhe profesionalizimit, gjë e cila ti përgjigjet standarteve më të larta që kërkohen për realizimin e objektivave, vizionit dhe misionit të Institucionit.

Objektiv 2. Kualifikimi në vijueshmëri i burimeve njerëzore

Objektiv 3. Garantimi i realizimit në kohë të shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritja e performancës së tij

Produktet që u realizuan:

- Plotësimi me burime njerëzore i vendeve të lira sipas strukturës së miratuar në mbështetje të planit vjetor të rekrutimit sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi (Shërbim civil + Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë) sipas parimit të meritës, aftësive dhe profesionalizimit.
- Përmirësimi i infrastruktures në lidhje me kushtet e punës (blerja e pajisjeve kompjuterike për administratën).

- Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime .

Çeshtjet financiare dhe fiskale , Çeshtjet e Brendshme .

Politika e programit : Forcimi i financave vendore nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit fiskal në nivel vendor. Zbatimi efikas i buxhetit dhe rritja e të ardhurave, duke formalizuar ekonominë nëpërmjet reduktimit të ekonomisë informale dhe rritjes së të ardhurave nga tatimet

Pershkrimi i programit:

- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.
- Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Qellimi i politikës së programit: Përmirësimi i Financave te Bashkise

Objektivat e politikës së programit:

- Hartimi politikave për rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat në zbatim të paketës fiskale dhe planit të të ardhurave në funksion të realizimit të buxhetit të bashkisë.
- Rritja e të ardhurave të bashkisë nëpërmjet një menaxhimi sa më të mirë të pronave të bashkisë, rritjen e numrit të pronave të regjistruara në Z.R.P.P, me qëllim rritjen e numrit të ambjenteve të dhëna me qira ose kontrata të tjera si dhe monitorim sa më efikas i tyre.
- Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe përmirësimi i klimës së biznesit përmes dhënies dhe aksesit të lehtësuar të informacionit për të bërit biznes në Diber:

Produktet që u synuan te ofrohen .

- Përmirësimi i sistemit të programit të administrimit të taksave vendore me element të tjerë , integrimi i sistemit të gjobave të policisë bashkiake në sistemin e Policisë së shtetit.
- Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet dhe potencialin e tyre.
- Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse

Treguesit e performances per programin Planifikim, Menaxhim dhe Administrim :

1. Numri total I punonjeseve te bashkise 149 punonjes

Nr. total punonjeseve femra qe punojne ne administraten e Bashkise 63 punonjese

Nr. total punonjeseve meshkuj qe punojne ne administraten e Bashkise 86 punonjese

000 mije

Programi ,01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	01110	1	600	147,773	120,542	118,390	80.1%
0	01110	1	601	24,677	18,232	18,232	73.8
0	01110	1	602	48,276	28,583	28,583	59.2
0	01110	1	604	14,000	10,800	3,550	25.3
0	01110	1	606	9,066	7,066	1,235	13.6
0	01110	1	609	25,000	9,067	585	2%
0	01110	1	230	5,000	5,000	0	0%
0	01110	1	231	9,050	0	0	0%
				282,842	199,290	170,575	60.3%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin programin planifikim , menaxhim, administrim krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 60.3 %

➤ **Programi 01170 Gjendja Civile**

Politika e programi: Zbatimi i ligjit per gjendjen civile si dhe sherbimi ne kohe per qytetaret
Qellimi i politikës se programit buxhetor: Sigurimi i hedhjes, ruajtjes dhe ndryshimit te perberesve te gjendjes civile te shtetasve shqiptare, shtetasve te huaj dhe te personave pa shtetesi, me banim te perkoshem /te perhershëm ne RSH.

Objektivi i politikës se programit: Funkzionimi efikas dhe eficient i sherbimit te gjendjes civile.

Funksioni i deleguar per gjendjen civile per 8- mujorin e vitit 2024 eshte realizuar ne masen 57 %
 Jane derdhur rregullisht kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

000 mije

Programi 16 1170 Gjendja Civile							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
16	1170	1	600	13,750	6,695	6,695	48.6%

16	1170	1	601	2,259	1,934	1,934	85.6%
16	1170	1	602	1,314	1,271	1,271	96.7%
TOTALI				17,324	9,901	9,901	57%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –muorin programin Gjendja Civile krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 57 %

Tregues të performancës së këtij programi:

I. Numri total i punonjësve gjendjes civile	13
Numri total i punonjësve femra	2
Numri total i punonjësve meshkuj	11

Produktet e Programit:

1. Koha në ditë për marrjen e dokumentit nga momenti i aplikimit menjëherë e në varesi të shërbimit që kërkohej.
2. Të ardhura të arketuara nga prodhimi i dokumenteve 446.000 leke .

➤ **Programi 03140**

Sherbimet Policore Vendore

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Politika e programit: Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut, nëpërmjet uljes së kohës së përgjigjes së policisë ndaj thirrjeve të komunitetit dhe rritjes të numrit të thirrjeve të publikut

Pershkrimi i programit:

Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;

Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë.

Qëllimi i politikës së programit: Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut, nëpërmjet uljes së kohës së përgjigjes së policisë ndaj thirrjeve të komunitetit .

Objektivi i politikës së programit: Rritja e Shërbimeve Bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitete

Policia vendore (Policia Bashkiake) është në ndihmë të realizimit të funksioneve të tjera.

000 mije

Programi '03140 Shërbimet e Policisë Vendore							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I i vitit 2024 Perfundimtar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	03140	1	600	7,535	5,528	5,528	73.3%
0	03140	1	601	1,258	838	838	66.6%
TOTALI				8,793	6,366	6,366	72.3%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –mujorin programin shërbimet e policisë vendore krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 72.3 %

Treguesi i performancës në shërbimet e policisë vendore

I. Numri total i punonjësve të policisë bashkiake	13
Numri total i punonjësve të policisë bashkiake femra	0
Numri total i punonjësve të policisë bashkiake meshkuj	13

➤ **Programi 03280**

➤ **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**

Pershkrimi i politikës së programit: Programi mbulon luftën kundër zjarrit, parandalimin e zjarrit dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentale.

Qëllimi i politikës së programit: Permisimi i sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit.

Objektivi i politikës së programit: Permisimi i shërbimeve dhe infrastrukurës së shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit

000 mije

Programi '03280 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I i vitit 2024 Perfundimtar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	03280	1	600	19,200	13,600	13,593	70.7%
0	03280	1	601	3,205	2,485	2,485	77.5%
0	03280	1	602	4,398	2,446	2,427	55.1%
0	03280	1	231	2,500	2,500		0%
TOTALI				29,303	21,031	18,505	63.1%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –mujorin programin mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 63.1%

Treguesit e performances per programin mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civili:

➤ **1.Numri total i punonjësve të Mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civil 20**

Numri total i punonjësve femra 0

Numri total i punonjësve meshkuj 20

2.Numeri total I punonjesve te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi . 18

3.Numeri total I makinave zjarrefikese , 3

4. Numeri total I stacioneve zjarrefikese ne teritorin e bashkise Diber, 1

➤ **Programi 04240**

Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Pershkrimi i programit buxhetor: Ky program lidhet me Menaxhimin e ujitjes dhe Kullimit.Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla. Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësisë të veteqeverisjes vendore.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Administrimi, shfrytëzimi dhe mirembajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Objektivi i politikës së programit buxhetor: Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

000 mije

Programi '04240 Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I i vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitet 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	04240	1	600	1,580	1,549	1,549	98%
0	04240	1	601	276	210	210	76%
0	04240	1	602	326	320	320	98.1%
0	04240	1	231	29,686	17,382	17,382	58.5%
TOTALI				31,868	19,461	19,461	61%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin programin menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 61%

Treguesit e performances se programit te menaxhimit te infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit:

1.Numri total i punonjësve 3

Numri total i punonjësve femra 0

Numri total i punonjësve meshkuj 3

2. Kanale ujitëse dhe kulluese të pastruara/mirëmbajtura (Km linear), 150

3.Rrjet ujitës funksional në pronësi të bashkisë në total në km , 477

4. Numri total i digave dhe rezervuarëve funksional , 22

5.Numri total i digave funksionale , 17

6.Numri total i rezervuarëve funksional , 17

➤ **Programi 04260**

➤ **Menaxhimi i Pyjeve dhe kullotave**

Pershkrimi i programit buxhetor: Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave në funksion të rritjes ekonomike dhe rritjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullimore.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Mbrojtja dhe rritja e sipërfaqeve pyjore kullimore, shërbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.

Objektivi i politikës së programit buxhetor: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore, kullimore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni.

000 mijë

Programi '04260 Administrimi i Pyjeve e Kullotave							
GR	PROG	KAP	ART	Plani i vitit 2024 Përfundimtar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	04260	1	600	5,053	5,053	2,997	59.3%
0	04260	1	601	455	455	454	9.7%
0	04260	1	602	3,828	1,775	1,602	49.6%
TOTALI				9,336	7,283	5,053	54.1%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –mujorin programin administrimi i pyjeve dhe kullotave krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 54.1%

Treguesit e performancës për programin Administrimi i pyjeve dhe kullotave :

1. Sipërfaqe totale e fondit kullimor (në ha), 26.309
2. Numri i punonjësve për menaxhimin pyje-kullota ,23
3. Sipërfaqe pyjore me plan menaxhimi në ha ,0

Programi 04520 Rrjeti Rrugor Rural

Pershkrimi i programit buxhetor: Ofrimi i një shërbimi cilësor në ndërtim dhe rikonstruksion të rrugëve , mirëmbajtjen e rrugëve rurale, urbane trotuareve, sinjalistikës rrugore si dhe sistemit të kanalizimit të ujërave të bardha ,mirëmbajtjen e trotuareve, kalldrime ekzistuese si dhe shtimin e sipërfaqeve të reja.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të rrjetit rrugor rural.

Objektivi i politikës së programit buxhetor:

- Ofrimi i nje sherbimi cilesor ne mirembajtjen e rrugeve urbane, trotuareve, sinjalistikes rrugore si dhe sistemit te kanalizimit te ujrave te bardha ,mirembajtjen e trotuareve, si dhe shtimin e sipefaqe te reja.
- Ofrimi i nje sherbimi cilesor ne mirembajtjen e rrugeve rurale.

000 mije

Programi '04520 Rrjeti rrugor rural							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	04520	1	600	11,016	8,000	7,995	72.5%
0	04520	1	601	1,840	1,250	1,245	67.6%
0	04520	1	602	14,822	5,630	1,481	9%
0	04520	1	230	10,000	10,000		0%
0	04520	1	231	275,745	236,302	114,014	41.3%
				313,423	261,182	124,735	39.7%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin programin rrjeti rrugor rural krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 39.7%

Treguesit e performances per programin Rrjeti Rrugor Rural:

1. Rrjeti rrugor në km linear në total (rural/urban) , 642
2. Gjatësia e rrjetit rrugor urban nën administrimin e bashkisë në km , 36
3. Rrjet rrugor urban i pajisur me sinjalistikë rrugore (në km) , 13
4. Rrjet rrugor urban i ndriçuar në km , 30
5. Rrjet rrugor urban i shtruar ose asfaltuar (në km) ,

➤ Programi 05100

Menaxhimi i mbetjeve

Pershkrimi i programit buxhetor: Programi i menaxhimi i inetgruar i mbetjeve urbane parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet. Ky shërbim eshte shtrire edhe ne njesite administrative te bashkise.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti, si dhe në ambientet ku qytetarët te shlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla dhe ne fshatra etj.)

Objektivi i politikës së programit buxhetor: Permirësimi i menaxhimit te integruar te mbetjeve urbane.

Ky program realizohet me sipermarrje ne bashkine tone dhe eshte i shtrire ne te gjithe teritorin.

000 mije

Programi '05100 Menaxhimi I Mbetjeve							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor vitit 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori vitit 2024
0	05100	1	600	13,200	10,700	10,700	81%
0	05100	1	601	2,204	1,450	1,450	65.7%
0	05100	1	602	3,089	1,800	1,023	33.1%
0	05100	1	231	1,800	1,800	0	0%
				20,293	15,838	13,173	64.9%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 –mujorin programin menaxhimi i mbetjeve krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 64.9%

Treguesit e performances per programin Rrjeti Rrugor :

- Kazanë mbeturinash në total , 350
- Makineri pastrimi në total , 5
- Pika të vendqëndrimit të kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve , 279
- Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë , 75.323
- Popullsia në Peshkopi 18.783
- Popullsia në Njesite administrative, Diber 56.540
- Popullsia totale e mbuluar me sherbim , 79%
- Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet , 100%
- Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë administrative ,

Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA)

-në qytet dhe Njesite Administrative:

Frekuenca në Qytet 2 here /dite ne zona te caktuara.

Frekuenca në Njësitë administrative 1 here / jave ndersa ne zonen e Maqellares 4 here ne jave .

Blerja e nje makine teknologjike , 30 konteniere me fondet e ambasades Japoneze bene te mundur shtrirjen me sherbim edhe ne njesite e tjera si dhe permiresimin e cilesise se sherbimit ne qytet duke rritur frekuencen e sherbimit .

➤ Programi 06260

➤ Sherbimet Publike Vendore

Pershkrimi i programit buxhetor:

Politika e ketij programi eshte permiresimi i kushteve mjedisore dhe hapesirave te perbashketa komunitare sa me te kendshme dhe funksionale, sipas standarteve bashkekohore , krijimit te nje ambienti çlodhes dhe argetues per te gjalleuar jeten komunitare dhe kohezionin social.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Sigurimi i një niveli të lartë të shërbimeve publike ndaj qytetarëve

Sigurimi i standardeve të shërbimeve publike përmes hartimit të akteve për secilin shërbim publik në nivel vendor sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore që rregullon funksionin.

000 mije

Programi '06260 Shërbimet Publike							
GR	PROG	KAP	ART	Plani i vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor vitit 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori v:ti 2024
0	06260	1	600	66,345	48,039	48,039	7.4%
0	06260	1	601	11,078	7,652	7,595	68.5%
0	06260	1	602	45,137	31,915	20,835	46.1%
0	06260	1	231	13,061	9,274	0	0%
				135,621	96,880	76,469	56.3%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –mujorin programin shërbimet publike krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 56.3 %

Objektivi i politikës së programit buxhetor:

- Sigurimi i standardeve të shërbimeve publike përmes hartimit të akteve për secilin shërbim publik në nivel vendor sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore që rregullon funksionin
- Mirembajtjen e struktureve të sipërfaqeve të gjelbërta duke kryer të gjitha proceset teknologjike të punës për mirembajtjen e sipërfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure të gjelber.
- Mirembajtja e varrezave publike dhe të deshmorëve .
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, sipërfaqe me bar, mbjellja e pemëve dekorative etj.
- Mirembajtja e ambienteve dekorative, stolave në të gjitha sipërfaqet e gjelbërta.

Treguesit e performancës për programin Shërbime Publike Vendore (Bashkia) :

1. Gjatësia e rrjetit rrugor urban nën administrimin e bashkisë në km , 642
2. Rrjet rrugor urban i pajisur me sinjalistikë rrugore (në km) , 13
3. Rrjet rrugor urban i ndriçuar në km ,30

➤ Programi 06330

➤ Furnizimi me ujë dhe kanalizime

Pershkrimi i këtij programi buxhetor: Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për administrimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, si dhe ngritjen ose vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

000 mije

Programi '06330 Ujesjelles dhe kanalizime							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitet 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	06330	1	231	47,501	47,501	34,044	71.6%
				47,501	47,501	34,044	71.6%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin programin furnizimi me uje dhe kanalizime krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 71.6 %

➤ **Programi 08130**

➤ **Sport dhe Argetim**

Pershkrimi i programit buxhetor:

Politika e ketij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe perhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Rritja e cilësisë sportive pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, futbollit dhe volejbollit të ngritura pranë klubit të Shumesportit.

Objektivi i politikës së programit buxhetor:

-Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.
-Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.

000 mije

Programi '08130 Futblli, shumesporti							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	08130	1	600	8,922	6,340	5,630	63.1%
0	08130	1	601	1,490	1,140	955	64%
0	08130	1	602	26,250	20,600	19,468	74%
				36,662	28,080	26,053	71%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin programin Futboll, Shumesport krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 71%

➤ **Programi 08220**

➤ **Trashegimia kulturore , Eventet Artistike dhe Kulturore**

Pershkrimi i programit buxhetor: Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit kulturor, Ruajtja dhe promovimi i vlerave te trashgegimise kulturore te qytetit.

Qellimi i politikës së programit buxhetor: Politika e këtij programi synon krijimin e nje jete sa me te pasur kulturore dhe sociale per qytetin e Dibres duke perfshire te gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale qe bashkejetojne me Diber.

Objektivi i politikës së programit buxhetor: Promovimi i enteve kulturore dhe artistike si dhe larmia e e jetes kulturore dhe artistike ne bashkine Diber.

000 mije

Programi '08220 Kultura							
GR	PROG	KAP	ART	Plani i vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	08220	1	600	14,940	10,720	9,587	64%
0	08220	1	601	2,495	1,694	1,560	62.5%
0	08220	1	602	3,600	2,100	1,301	36%
0	08220	1	231	455		454	99%
				21,490	14,514	12,902	60%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 –mujorin programin kultura krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 60%

➤ **Programi 07220**

➤ **Qendra balneare**

Ky institucion ofron sherbime ndaj te semureve qe kurohen prane ketyre ujerave. Klientet qe frekuentojne Ilixhat jane sezonale dhe ne pikun e tyre e kane ne periudhen Prill-Maj dhe Shtatore – Tetor, te shtruar ne hotelin e institucionit dhe private.

Ne kete qender funksionojne keto terapi: hidroterapia, terapia me balte, pishina dhe hoteleria.

000 mije

Programi '07220 Qendra balneare							
GR	PROG	KAP	ART	Plani i vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	7220	1	600	16,800	16,800	15,482	92%
0	7220	1	601	2,750	2,750	2,587	94%
0	7220	1	602	6,000	6,000	1,403	23.3%

				25,550	25,550	19,472	76.2%
--	--	--	--	--------	--------	--------	-------

% e realizimit te shpenzimeve per 8 –mujorin programin kultura krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 76.2%

➤ **Programi 09120**

➤ **Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor.**

Pershkrimi i programit buxhetor: Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore të arsimit bazë dhe parashkollor sipas standardeve

Qellimi i politikës se programit buxhetor:

Sigurimi i kushteve të përshtatshme të infrastrukturës dhe sigurisë për arsimin bazë sipas standardeve dhe rritja e numrit të fëmijëve që ndjekin arsim parashkollor me cilësi

Objektivi i politikës se programit buxhetor:

Bashkia Ofron kushte per permirsimin e arsimit baze dhe parashkollor Permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit. Te realizoje mirembajtjen e kopshteve, cerdheve, dhe shkollave te qytetit, duke synuar ne pambushjen e standarteve optimal ne ambientet e mesimdhenjes.

000 mije

Programi '9120 Arsimi baze							
GR	PROG	KAP	ART	Plan i i vitit 2024 Perfundimar	Plan 8–mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	09120	1	600	166,109	123,714	123,296	74.2%
0	09120	1	601	27,740	19,074	19,074	68.7%
0	09120	1	602	59,364	45,009	25,964	43.7%
0	09120	1	606	650	650	650	100%
0	09120	1	230	256	256	256	100%
0	09120	1	231	38,432	17,458	17,458	45.4%
				292,551	206,161	186,698	63.8%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 –mujorin programin arsimi baze krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 63.8%

➤ **Programi 09230**

➤ **Arsimi i Mesem i Pergjithshem**

Pershkrimi i programit buxhetor: Programi mbështet arsimin e mesëm të përgjithshëm, duke siguruar dhe mjediset shkollore stafit mbështetës (rojet, sanitare ne shkollat e qytetit dhe njesite administrative)

Qellimi i politikës se programit buxhetor: Sigurimi i kushteve të përshtatshme të infrastrukturës dhe sigurisë për arsimin e mesëm të përgjithshëm sipas standarteve.

Objektivi i politikës së programit buxhetor: Bashkia ofron kushte për permisimin e arsimit të përgjithshëm (të mesëm)

000 mije

Programi '09230 Arsimi I mesëm							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Përfundimtar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit të vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	09230	1	600	7,800	5,200	4,827	61.8%
0	09230	1	601	1,302	700	795	61.1%
0	09230	1	602	2,394	2,023	1,744	72.8%
TOTALI				11,496	7,923	7,367	64%

% e realizimit të shpenzimeve për 8 –mujorin programin arsimi i mesëm krahasuar me planin e buxhetit për të vitit 2024 është 64%

Programi 10430

➤ Perkujdësi social

Përshkrimi i programit buxhetor: Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhës pranë njësisë vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta.

Qëllimi i politikës së programit buxhetor: Sigurimi i kushteve të përshtatshme të infrastrukturës dhe sigurisë për personat me aftësi të kufizuara dhe ndihme ekonomike

000 mije

Programi '010430 Perkujdësi social							
GR	PROG	KAP	ART	Plani I vitit 2024 Përfundimtar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit të vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
0	010430	1	600	21,445	16,044	15,534	72.4%
0	010430	1	601	3,581	2,380	3,178	88.7%

0	010430	1	602	10,196	3,500	1,326	13%
0	010430	1	602				
0	010430	1	606	772,310	772,310	546,078	70.7%
0	010430	1	231	5,860	5,860	366	6%
TOTALI				813,392	800,094	566,482	69.6%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 –mujorin programin perkujdesi social krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 69.6%

E.% E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE TE 8-MUJORIT TE VITIT 2024

000 mije				
EMERTIMI	Plani I vitit 2024 Perfundimar	Plan 8-mujor viti 2024	Realizim 8 mujorit te vitit 2024	% e real. 8 mujori viti 2024
8-mujori I vitit 2024	2,097,235	1,765,047	1,297,243	61.8%

% e realizimit te shpenzimeve per 8 -mujorin krahasuar me planin e buxhetit per te vitit 2024 eshte 61.8 %

F.TREGUESIT FINANCIARE

Treguesit financiare perdoren per te vleresuar qendrushmerine financiare se njesise se vetqeverisjes vendore , informuar aktoret kryesore si:

- 1.Kryetarin e njesise se vetqeverisjes vendore .
2. Keshillin e njesise se vetqeverisjes vendore .
3. Komunitetin vendor.
4. Taksapaguesit .
- 5.Ministrine e Financave
6. Kreditoret.

Analiza dhe raportimi i treguesve financiare i mundeson njesise te kuptoje me mire aspektet financiare te saj dhe njesive administrative. Ky informacion i kombinuar me elemente te tjere ekonomik, demografik dhe social te njesise ndihmon analizen dhe marrjen e masave perkatese nga ana e Ministrise se Financave dhe Ekonomise dhe njesive te vetqeverisjes vendore per te bere krahasime midis tyre dhe mbajtjen e financave vendore nen monitorim.

Me ane te analizave se treguesve financiare merret informacion ne lidhje me:

- **Cilat jane prioritetet e njesise se vetqeverisjes vendore :**

- 1.Prioriteti I Bashkise eshte permisimi i infrastruktures arsimore ne te gjithe teritorin e saj dhe njesite administrative, rritja e numerit te te punesuave , zhvillimi ekonomik si dhe rritja e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve .
- 2.Fokusi kryesor eshte dhe do te jete vazhdimi I konsolidimit te procesit te menaxhimit financiar ne funksion te vazhdimit te mireqeverisjes vendore.

- **Çfare burimesh ka ne dispozicion njesia:**

- 1.Burimet Qendrore ku perfshihen transfertat e pakushtezuara dhe transfertat sektoriale per funksionet e reja qe I transferohen bashkise dhe transfertat e kushtezuar.

2. Nga burimet e veta vendore ku perfshihen te ardhurat tatimore (taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat per sherbimet publike qe ofrojn dhe te ardhurat e tjera vendore).

- **Si perdoren fondet publike te njesise se vetqeverisjes vendore:**

1. Rritja e kerkeses se qytetareve per sherbime cilesore dhe sa me prane tyre ka diktuar domosdoshmerine e nje decentralizimi te thelluar fiskal dhe transferimi e shume funksioneve publike drejt njesive te vetqeverisjes vendore. Ne kete konteks rritja e kompleksitetit te funksioneve e pergjegjesive ndaj qytetareve do te reflektohet ne permisimin e hapave te menaxhimit te financave publike ne nivel vendor si nje instrument shume i rendesishem i ketij procesi.

- **Sa ruhet disiplina fiskale**

1. Forcimi I disjplines fiskale ruhet duke respektuar rregullat dhe parimet e sankionuara me ligj ne hartimin, konsultimin, miratimin, zbatimin, raportimin dhe auditimin e buxhetit vendor, duke synuar nje menaxhim te shendoshe financiar.

G.DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Detyrimet e prapambetura deri me date 31.08.2024 jane ne vleren 158,835,215 leke.

Nr.	Emertimi	shuma e detyrimit
1	Investimet	121,655,431
2	Mallra e sherbime	18,930,147
3	Vendime Gjyqesore	17,373,221
4	Paga sigurime	876,416
		158,835,215